

Informacion i përgjithshëm mbi aplikimet për Masterin Ekzekutiv në “Menaxhim Farmaceutik dhe Inovacion” për vitin 2026-2027

Për të aplikuar në programin në ciklin e tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në “Menaxhim Farmaceutik dhe Inovacion”, kandidati duhet:

- Të ketë përfunduar studimet universitare jo më pak se 300 ECTS (program të integruar të ciklit të dytë ose bachelor dhe master i shkencave) brenda ose jashtë vendit. Për diplomat e fituara jashtë vendit, kandidatët duhet të kenë kryer njehsimin dhe ekuivalentimin e diplomës pranë institucionit përgjegjës.
- Të ketë dy rekomandime nga persona që gëzojnë titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit.
- Të ketë të mbrojtur e të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare një prej 5 gjuhëve të BE (Niveli B2 përcaktuar me Vendim të Senatit Akademik UMT).¹ Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- *Fusha e studimeve paraardhëse të kandidatëve*
 - Farmaci
 - Mjekësi e përgjithshme
 - Stomatologji
 - Shkenca të Shëndetit (shëndet publik apo të ngjashme me to)
 - Bioteknologji Mjekësore; Farmaceutike; Industriale
 - Shkenca të Natyrës (nënfusha biokimike)
 - Ose fusha studimi ekuivalente me sa më lart,

Programi i ciklit të tretë të studimit Master Ekzekutiv në Menaxhim Farmaceutik dhe Inovacion, përfshin veprimtaritë formuese si më poshtë:

Etikë shëndetësore dhe komunikim; Menaxhim farmaceutik dhe marketing; Inovacioni në farmaceutikë; Aspekte ligjore dhe aplikative të kërkimit klinik; Farmakoekonomi dhe farmakoepidemiologji; Planifikim dhe akses i barnave në tregun farmaceutik; Politika shëndetësore dhe legjislacion; Siguria e barnave dhe farmakovigjilenca; Tema e diplomës

Tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2026-2027 është 115 000 lekë (miratuar me Vendim nr. 28, datë 20.05.2026 të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë).

Afati i aplikimit: 21 shtator 2026-05 tetor 2026 pranë Fakultetit të Mjekësisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

¹ Dokumenti i njohjes së gjuhëve të huaja, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formular aplikimi, sipas modelit të parashikuar në Shtojcën nr. 2, Udhëzimi nr.12/2023 i ndryshuar i MAS;
- b) Një letër motivimi e aplikantit;
- c) Curriculum vitae e aplikantit;
- d) Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, kartë identiteti ose pasaportë;
- e) Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e diplomës universitare, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" si dhe të ciklit të dytë "Master i Shkencave", ose të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë, dhe listës / listave të notave. Për rastet e diplomave të huaja paraqitet kopje e njësuar me origjinalin e vërtetimit të njohjes së diplomës në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me diplomën /diplomat dhe listën / listat përkatëse të notave;
- f) Kopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë e dokumentit që vërteton njohjen e gjuhës së huaj, të paktën në një nga gjuhët e huaja (anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht) në nivelin B2. Dokumenti i njohjes së gjuhëve të huaja, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testeve ndërkombëtare (sipas Udhëzimit nr.52/2015 i MAS);
- g) Dy fotografi personale;
- h) Deklaratë sipas, shtojcës nr. 1, Udhëzimi nr.12/2023 i ndryshuar i MAS;
- i) Mandat pagesa për tarifën e aplikimit prej 2000 (dymijë) lekë.

Dokumente të tjera:

- a. Dy rekomandime nga persona që gëzojnë titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- b. Kopje e njësuar me origjinalin të librezës së punës.